# DËSHMI ARKIVI

**A-476586**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | “Rama dhe Berisha u takuan në Rinas”, Salianji bën deklaratën e fortë: Kreu i PD të tregojë çfarë biseduan. U kërcënuan punonjësit e Gardës… |
| ADRESA | `https://shqip.com/rama-dhe-berisha-u-takuan-ne-rinas-salianji-ben-deklaraten-e-forte-kreu-i-pd-te-tregoje-cfare-biseduan-u-kercenuan-punonjesit-e-gardes/` |
| BURIMI | shqip.com |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 28 shtator 2026, 14:10:34 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 28 shtator 2026, 14:07:19 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `911f2a144bf45dfcc95afde7267cc42546933a3201f2425795cd830e833d5ec8` |
| TEKSTI | `3f9a6ff0f8f43276ff6f321c7de9001cb6c0ba6cdafe497c965b145d0901c045` |
| PAMJA | `a440bd4bc294d9198004fd4d523f55ac65056e2427532605115a1662ab1f1a19` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `582e7a4e9e4c61818a01f5e163a80c819179647f0ce72403d6f1f60fe5341157` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `282274d0ff18f09ea4854e79728659ffe2d6cd028bfa2085cb95da6ce0a699bb` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/582e7a4e9e4c61818a01f5e163a80c819179647f0ce72403d6f1f60fe5341157`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Lajme

# "Rama dhe Berisha u takuan në Rinas", Salianji bën deklaratën e fortë: Kreu i PD të tregojë çfarë biseduan. U kërcënuan punonjësit e Gardës...

Shqip

Publikuar: (28.09.2026 16:07:19)



Share

Ish-deputeti i PD, Ervin Salianji shprehet se kryeministri Edi Rama dhe kreu demokrat, Sali Berisha janë takuar dje në sallën VIP të aeroportit të Rinasit. Në studion e "Minuta e Parë" me Ola Bruko, në News24, Salianji tha se lideri demokrat duhet të tregojë çfarë bisedoi me Ramën.

Salianji denoncoi gjithashtu se janë kërcënuar punonjësit e Gardës të cilët shoqëronin Ramën, pasi nxorën informacionin e takimit me kreu e opozitës.

"Ata u takuan tamam. I takon Sali Berishës si patericë e Edi Ramës të tregojë çfarë ka folur me kryeministrit. Teatër bëjnë sa të duash. Kërcënojnë punonjësit e Gardës me largim nga puna pse më kanë sjellë mua informacion. Ky zotëria duhet të thotë pse i shërben Edi Ramës dhe a kanë bërë marrëveshje këta? Informacioni që kam unë dje, ishte ky. Të dy ishin në të njëjtën kohë në Rinas, Edi Rama ishte në Rinas, shkoi edhe ky. është hera e dytë. Kur shkon Sali Berisha atje, qëllon edhe Edi Ramën. Po të isha unë nuk hyja fare po të ishte Rama. Ça pune ka ky? U vonua edhe konferenca për shtyp e Ramës 1 orë e pak. Tani ma thoni pak çfarë duhet të bëjë opozita përveçse të reagojë fort, të thërriste ndërkombëtarët dhe të thoshte nuk i mbajmë dot më shqiptarët. Çfarë është ajo në Parlament? U çuan në Parlament e bllokove, i ti Pelesh, me lesh pa lesh, këtu është kapur shefja e shërbimit duke iu shërbyer grupeve kriminale. Si ka mundësi që nuk thërret protestë paradite, pasdite, të ngrejë në këmbë Shqipërinë", tha Salianji.

/Shqip.com

TË FUNDIT N'SHËNJESTËR


VIDEO/ Skandali i radhës i KMY, shet salçiçe me spango muratori
Lajme


Skandali i Intesa Sanpaolo Bank/ Si iu grabitën 100 milionë euro përmes një telefonate të rreme
Lajme


"A u tërhoq Rama nga dorëheqja pas bisedës me Berishën"? Trondit Ervin Salianji: Kryeministri dhe kreu i PD u takuan në Rinas
Lajme


TRAGJEDIA/ 4 anëtarët e familjes shqiptare u shuan në Athinë. Florinda dhe bashkëshorti ishin në muaj mjalti, vëllai i saj dhe kunata po prisnin një fëmijë
Lajme


SPAK hap dosjen Baks-Rrjoll/ Roli i "zonjës" së territorit Adelina Greca, "Gener 2", vëllezërit Efthimi dhe plani që urbanizoi tokat e resorteve. Në skenë edhe emri i Elira Kokonës e Fatmir Shpellza
Lajme


Në rrjet u tha se do të jepte dorëheqje/ Ja çfarë deklaroi Rama nga Rinasi (Fjala e plotë)
Lajme


Rama mbërrin në Rinas dhe anulon konferencën urgjente, do t'i adresohet shqiptarëve me videomesazh
Lajme


Çfarë do deklarojë? Rama pritet të mbërrijë në Rinas në orën 13:00, masa të shtuara sigurie në aeroport
Lajme


WSJ: Si e ndihmoi ambasadorja amerikane kompaninë greke të sigurojë marrëveshjen 6 miliardë dollarëshe në Shqipëri
Lajme


Si u spastruan banorët e Taçit nga tokat e tyre/ Fortis Energy rrëmbeu 412 hektarë toka dhe kullota për central diellor
Lajme

N'SHËNJESTËR




Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.